

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTIT TË PËRGJITHSHËM

PADITËSI:

- QKOMUNA E XX, REPUBLIKA E KOSOVËS, ME ADRESË: RRUGA XX, P.N. TË CILËN E PËRFAQËSON PËR FAQËSUESI LIGJOR XX, NË TEKSTIN NË VIJIM, REFERUAR SI “PADITËSI”

I PADITURI:

- QEVERIA E REPUBLIKES SE KOSOVES -MINISTRIA E SHENDETESISE, ME ADRESË:RRUGA ZAGREBIT NUMER 6010000, PRISHTINE, NË TEKSTIN NË VIJIM, REFERUAR SI “I PADITURI”

PADI

për

KOMPENSIMIN E DËMIT MATERIAL

Vlera e kontestit _____

➤ **Përmbledhja e fakteve:**

1. Më datë 12 qershor 2018, e paditura dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (KKS) kanë lidhur Kontratën Kolektive Sektoriale. Kontrata është e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe KKS-së dhe e nënshkruar nga titullarët e atëhershëm. Kontrata ka hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit pra me datë 12.06.2018, e cila kontrate në nenin 2 të saj ka parapare afatin prej 3 viteve, rrjedhimisht deri në lidhjen e kontratës së re, që nënkupton që e njëjta është ende në fuqi.

Provë: e pakontestuar (Kontrata Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2018):

2. Më datë 19 janar 2022, Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), ka parashtruar te Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkesën për mbulimin e shpenzimeve të krijuara nga zbatimi i Kontratës Kolektive për Arsim dhe atë për Shëndetësi.
3. Në të njëjtën ditë (19 janar 2022), Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, të njëjtën kërkesë e ka parashtruar edhe të ministritë e fushave përkatëse, me qëllimin që të informohen për pasojat e zbatimit të kontratës në raport me komunat, duke ofruar edhe propozimet konkrete, pa e kontestuar zbatimin e kontratave kolektive përkatëse.
4. Me 25 shkurt 2020, Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), ka informuar Ministrinë e Shëndetësisë për Implikimet financiare që po i shkakton Kontrata Kolektive Sektoriale për Komunat e Republikës së Kosovës.
5. Po ashtu me 11 shtator të vitit 2018, Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), ka informuar Ministrinë e Financave për Implikimet shtesë buxhetore që po i shkakton Kontrata Kolektive Sektoriale për Komunat e Republikës së Kosovës.
6. Me 30 Qershor të vitit 2022 Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës ka bërë dy pyetje: Për Opinionin e vlerësimit të ndikimit Buxhetor nga Ministria e Financave dhe Transfereve dhe A është e Regjistruar Kontrata Kolektive, në Regjistrin e e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, sipas Ligjit të Punës, neni 90, pika 8 dhe 9 në këtë shkresë është shënuar email adresa elektronike dhe numri i telefonit, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje.
7. Sidoqoftë, qeveria nuk ka paraparë buxhetin e nevojshëm për zbatimin e kontratës kolektive Sektoriale, e as nuk e ka propozuar të njëjtin në projektligjin për buxhetin vjetor për vitin 2022, sikurse nuk është paraparë ndarja e nevojshme buxhetore as në vitet buxhetore paraprake, si 2021, 2020, 2019, 2018 e kështu më radhë.
8. Çështja e parë që konsiderojmë që është e rëndësishme për ta sqaruar përballë gjykatës, është baza ligjore për inicimin e procedurës gjyqësore, përmes mjetit juridik të njohur si

Padi. Prandaj, meqenëse, në bazë të nenit 5 (a) të Ligjit në fuqi për Vetëqeverisjen Lokale, shprehimisht përcaktohet statusi ligjor i komunës, si person juridik, e cila pos tjerash, ka kompetencë ligjore që të padisë dhe të paditet në gjykata, Komuna **x**, brenda afatit ligjor ushtron këtë padi për kompensim dëmi.

9. Me rastin e lidhjes së kontratës kolektive sektoriale në mes të paditurës dhe KKS-së, nënenin 4 të kësaj kontrate janë deleguar kompetenca dhe detyrime për paditësen pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë sepse në përmbajtjen e kontratës kolektive sektoriale parashihihen beneficioneve tëndryshme përpunëtorëtshëndetësornëformën e pagesave shtesë, e që përbëjnë kosto të pa përballueshme të shpenzimeve për paditësin.
10. Sepse, në të vërtetë këtë kontrate kolektive e ka lidhur e paditura, pa e shoqëruar zotimet e marra dhe kompetencat e deleguara me mjete financiare shtesë për komunat, në përgjegjësinë ligjore të të cilave është bartur zbatimi i këtyre akteve me kosto të madhe financiare.
11. Fakti i delegimit të kompetencave dhe obligimeve financiare ndaj paditësit aq sa është e drejtë etëpaditurësështëedhepërgjegjësisaj ligjoreqëtisiguroj edhe mjete financiare për zbatimin e kontratave kolektive sepse shpenzimet buxhetore janë enorme dhe e kanë dëmtuar seriozisht buxhetin e paditëses në dëm të qytetarëve të tjerë, pasi që, si rezultat i procedurave gjyqësore dhe përmbarimore ndaj komunës, nga ana e punëtorëve të sektorit të shëndetësisë, efektivisht janë bllokuar edhe kodet buxhetore që prekin zhvillimin ekonomik të paditëses, duke përfshirë “investimet kapitale” dhe “mallrat dhe shërbimet”, etj.
12. Rrjedhimisht, pa mundësia financiare e komunës për të përmbushur detyrimet financiare që rrjedhin nga kontrata kolektive sektoriale të cilën e ka nënshkruar e paditura, ka bërë që pothuajse të gjithë punëtorët e këtij sektori, në pamundësi që ti realizojnë benficionet që i parashohin dhe njohin kontratat kolektive sektoriale, të ndjekin rrugët ligjore të mbrojtjes gjyqësore për realizimin e të drejtave të tyre, gjë që e ka rënduar edhe më shumë gjendjen financiare të paditësit, sepse nga përmbarimet e dhunshme janë marrë mjete financiare në kategori të ndryshme e sidomos në kodet buxhetore që prekin zhvillimin e komunës, duke shkaktuar vonesa në realizmin e projekteve dhe duke shkaktuar dëmet e pariparueshme për paditësin.
13. Përkundër që e paditura është e obliguar sipas Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi që ti zbatoj obligimet e veta financiare në momentin kur delegon kompetenca tek organet lokale, një gjë e tillë, nuk ka ndodhur.
14. Në vijim, i referohemi nenit 124 par.3 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, sipas të cilit, përcaktohet shprehimisht detyrimi i të paditurës (si organ qendror dhe lartësi i

administratës shtetërore, respektivisht autoritet shtetëror që ka deleguar kompetencën), si në vijim:

*“Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. **Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.**”*

Po ashtu Kontrata Kolektive e cila na ka shkatuar deme te pariparueshem financiar te cilat jane te ne skruar nga niveli qendror bie ndesh me dispoziten ligjore te nenit 136, 137, te Ligjit per Mardhenjet e detyrimeve, ku ne baze te ketyre dispozitave ligjore barra e pergjigjesise ligjore dhe financiare bie mbi ate i cili e ka shkaktuar ate.

15. Ndërkaq, po ashtu, edhe me ligjin në fuqi për vetëqeverisjen lokale (2008), neni 18 përcakton detyrimin e të paditurës që kompetencën e deleguar ta shoqëroj me financim të nevojshëm. Paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, shprehimisht përcaktojnë:

“Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës mund t’u delegojnë kompetenca shtesë komunave, nëse është e nevojshme, në pajtim me ligjin.”

*“Kompetencat e deleguara duhet, në të gjitha rastet, **të shoqërohen me financim** të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.”*

16. Poashtu, duke u bazuar edhe në Ligjin nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, neni 5 shprehimisht përcakton se:

“Kur Qeveria i delegon një kompetencë një ose më shumë komunave, këto komuna, aq sa është e mundshme, mund ta përshtatin ushtrimin e këtyre kompetencave me kushtet lokale. Komuna duhet t’i ofrojë shërbimet të cilat rrjedhin nga një kompetencë e deleguar në mënyrë të hapur dhe të barabartë. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurojnë që në (Buxhetet komunale të Komunave) BKK komunave t’u ofrohen fondet e nevojshme për ushtrimin e kompetencave të deleguara; këto fonde duhet të jenë në një nivel të mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve të arsyeshme të komunës të bëra në lidhje me ushtrimin e këtyre kompetencave.”

17. Edhe me nenin 7 të këtij ligji është përcaktuar se burim financiar i paditësit është edhe grantet për kompetencat e shtuara dhe transferet për kompetencat e deleguara.

18. Me të njëjtin ligj, në nenet 26 dhe 27 është përcaktuar, pos tjerash se”

“Kur kompetencat Qeveritare u delegohen komunave, komunat përkatëse do të pranojnë financim nga BKK përmes transfereve nga ministritë përkatëse për ushtrimin e këtyre funksioneve. Ky financim është i veçantë nga Grantet Operative dhe duhet të bëhen në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.”

“Kur kompetencat vetanake të komunave shtohen në bazë të ligjit, komunat përkatëse do të pranojnë grante nga BKK për financimin e ushtrimit të këtyre kompetencave të

shtuara. Këto grante janë të veçanta nga Grantet Operative dhe epen në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji .Komuna është e detyruar t'i shpenzojë këto grant.Vetëm për çështjet të cilat në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë ndërlidhen me kompetencat e shtuara.”

19. Nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore të cekura më sipër, rezulton detyrimi i të paditurës ndaj paditëses sepse me rastin e nënshkrimit të kontratës kolektive sektoriale e paditura i ka deleguar përgjegjësisht e së paditëses si punëdhënëse e punëtorëve të shëndetësisë. Në anën tjetër është i pa kontestueshëm fakti se deri më tani paditësja nuk ka pranuar ndonjë grant shtesë që i përgjigjet detyrimeve të kontratës kolektive sektoriale karshi punëtorëve të shëndetësisë.
20. Prandaj, në këtë drejtim është fakt i pa kontestueshëm përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit ndaj paditëses.
21. Fakti i shkaktimit të dëmit në buxhetin e paditëses është fakt notor por që mund të provohet, sepse paditësja është e obliguar sipas nenit 4 të kontratave kolektive sektoriale që ta zbatojë këtë kontratë por se në anën tjetër e paditura si nënshkruese e kontratave nuk i ka siguruar të njëjtës grante shtesë për mbulimin e kostos financiare që rrjedhin nga kjo kontrate.
22. Andaj mbetet detyrim i të paditurës që ta mbulojë edhe me mjete financiare nga Buxheti i Kosovës për zbatimin e kontrates kolektive sektoriale sepse nga të hyrat vetanake që realizon paditësja nuk mund të mbulohen as shpenzimet komunale dhe grantet qeveritare të cilat ofrohen për komunën, por janë të destinuara për projekte dhe shpenzime tjera konkrete, ndërsa paditësja prej lidhjes së kontrates kolektive sektoriale vetëm ka marrë përgjegjësi për zbatim ndërsa nuk ka pranuar asnjë lloj granti shtesë për zbatimin e tyre por se realizimi i tyre është bërë në bazë të përmbarimit të dhunshëm me çka ka dëmtuar rëndë buxhetin e paditëses dhe ka shkaktuar çrregullime serioze në buxhetin komunal duke i ndal projektet e parashikuara dhe me këtë rast duke e ndal edhe zhvillimin ekonomik të paditëses.
23. Lartësinë e kompensimit paditësja e kërkon prej datës...(**varësisht kur është filluar të merren mjetën financiare ne komunat përkatëse**).
24. Lartësinë e kompensimit paditësja e kërkon vetëm pas konstatimit të vlerës së dëmit financiar në bazë të një ekspertize financiare që përfshin detyrimet që dalin nga kontrata kolektive sektoriale në raport me numrin e punëtorëve të shëndetësisë që përfitojnë si dhe të gjitha shpenzimet gjyqësore dhe të procedurës përmbarimore që janë shkaktuar deri më tash si pasojë e këtyre detyrimeve.
25. Po ashtu neni 136 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve thotë: Kush tjetrit i shkakton dem ka për detyrë ta kompensojë, e në rastin konkrete Ministria e Shëndetësisë me rastin e nënshkrimit të kontratës kolektive sektoriale i ka shkaktuar dem komunës sonë.

26. Sidoqoftë, paditësi, në bazë të një analize preliminare që e ka zhvilluar për nevoja të evidentimit të humbjeve dhe detyrimeve financiare që i janë shkaktuar, si dhe me qëllim të përafrimit të llogaritjes së dëmit të shkaktuar si rezultat i kësaj kontrate, ka ardhur në përfundim se, kompensimi i dëmit duhet të behët për sa vijon:

- Viti/et:
- Të punësuarit në arsim:
- Detyrimet financiare të paditësit për secilin vit, në raport me kontratën kolektive sektoriale:
- Konteste në procedurë gjyqësore dhe përmbarimore:
- Shumë e përafërt që e paditura duhet t'ia kompensoj paditëses për secilin vit;
- Të dhanëtë tjera relevante ([Komunat te sigurojne provat tjera, korespondenca mes komunes dhe nivelit qendror](#)) :

27. Për sa mësipër, paditësi, poashtu për mes kësaj padie, propozon edhe ekspertizë financiare nga eksperti i lëmisë financiare i cili do të konstatoj vlerën e dëmit të shkaktuar.

28. Andaj, mbi bazën e fakteve dhe argumenteve të cekura më lartë, në pajtim me dispozita te Ligjit në fuqi për Procedurën Kontestimore, paditësi përmes kësaj Padie, i propozon Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të merr këtë:

A K T G J Y K I M

1. **APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit Komuna **X**, si e bazuar.
2. **DETYROHET** Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Shëndetësisë që në emër të kompensimit të dëmit material ti paguaj paditëses vlerën e përcaktuar nga eksperti financiar, në afatin prej 15 ditë pasi që aktgjykimi të jetë bërë i plotfuqishëm.
3. **OBLIGOHET** e padituri që brenda afatit ligjor, të paguajë shpenzimet gjyqësore në lartësinë e cila krijohet deri në përfundimin e çështjes në procedurë gjyqësore, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Për dhe në emër të Paditësit:
